

PRANUAR MË:

ACCEPTED ON: 22-04-2022

PRIMLJENO:

Nr.No.Br. 11/729



Komuna e Malishevës

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT

në mes të

Komuna e Malishevës

DHE

OJQ "ABSM"- QENDRA EDUKATIVE

Ky Memorandum i Mirëkuptimit, (në tekstin e mëtejshëm Memorandumi) lidhet në mes të Komuna e Malishevës dhe OJQ "ABSM"- Qendra Edukative me Qender kryesore në Zvicerr dhe me degë në Gjakovë

Qëllimi i Memorandumit

Qëllimi i këtij Memorandumi është që të ofrojmë një kornizë të bashkëpunimit dhe të koordinimit në mes të palëve të lartpërmendura në fushën zhvillimit profesional të nxënësve dhe mësimit në Komuna e Malishevës

Neni I

Fushëveprimtaria

- ❖ Aktivitete të përbashkëta në fushën e arsimit dhe aftësimin profesional
- ❖ Zhvillimit të kapaciteteve të mësimdhënësve
- ❖ Projekte të përbashkëta
- ❖ Këshillimi dhe orientimi, tranzicioni në vendin e punës dhe vetëpunësimi
- ❖ Vizita studimore nga Kosova në Zvicërr dhe anasjelltas.

Neni II

Mënyra e bashkëpunimit

Të dy palët caktojnë nga një përfaqësues për ndjekjen dhe realizimin e bashkëpunimit që përcakton ky memorandum.

Komuna e Malishevës dhe ABSM pajtohen që për nevojat e tyre të shkëmbejnë ekspertët dhe përvojat e tyre në fushat të cilat mbulohen.

Neni III

Roli i palëve.

Palët pajtohen si më poshtë:

1. ABSM do të ofrojë shërbimet si më poshtë:
 - a) fuqizimin e kapaciteteve menaxhuese të shkollave në Komunën e Malishevës
 - b) ngritjen e kapaciteteve të mësimdhënësve në Komunën e Malishevës
 - c) Trajnime të ndryshme (Këshillim në karrierë, tranzicioni në vendin e punës dhe vetëpunësimi, Edukimi për ndërmarrësinë, Mësimi në vendin e punës ,etj
2. Komuna e Malishevës, Drejtoria e Arsimit përmes këtij memorandumit zotohet për koordinimin e shërbimeve për nxënës apo mësimdhënës, në pikat si më poshtë:
 - a) Llojin e trajnimit
 - b) Kohën e fillimit të trajnimit
 - c) Perzgjedhjen e shkollave dhe
 - d) Përzgjedhjen e kandidatëve

Neni IV

Pjesëmarrja në trajnime

Trajnimet dhe këshillimet për nxënësit dhe mësuesin nga Komuna e Malishevës do të jenë falas.

Neni V

Zotimet për të ardhmen

Komuna e Malishevës dhe OJQ "ABSM"- Qendra Edukative do të punojnë së bashku që t'i përgjigjen kërkesave të tregut të punës dhe nevojës për zhvillim profesional

Komuna e Malishevës dhe OJQ "ABSM"- Qendra Edukative së bashku do të kontribuojnë në drejtim të zhvillimit, përkrahjes dhe promovimit të sektorit edukativ dhe profesional në fushën e ndërmarrësisë dhe karrierës.

Neni VI

Kohëzgjatja e Memorandunit

Ky Memorandum ka afat të pacaktuar dhe mund të plotësohet edhe me anekse tjera.

Neni VII

Zgjidhja e Memorandunit

Ky Memorandum mund të zgjidhet edhe më herët me paralajmërim paraprak prej 60 ditëve nga palët e këtij memorandumi.

Data:22.04.2022, Malishevë

Palët nënshkruese:

Drejtorja për Arsim dhe Edukim

Arbëreshë Krasniqi, Drejtoreshë

ABSM, Gjakovë

Skender Nikoliqi, Drejtor ekzekutiv





